



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 54.
Prishtinë, më 6.11.2012 në ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Jasmina Živkovic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues i OSB-së Lejla Selimi, përfaqësuese e Sekretariatit të KKK Yijush Ahmeti, përfaqësuese e Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues i Instituti Demokratik i Kosovës –KDI Enis Xhemali, përfaqësues i zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Kordinatore - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës, me raportin e komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, me raportin e komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë me raportin e komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor , me amendamente**
6. **Të ndryshme**

Kryesuesi – konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara.

Kryesuesi - konstatoi se komisioni, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 16.10.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës, me raportin e komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që komisioni të deklarojë nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi, me raportin e komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-125 për Shëndetësi dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë me raportin e komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor , me amendamente

Komisioni shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë, dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

REKOMANDIM

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme.

Kryesuesi – theksoi se për realizimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian, grupi punues ka realizuar vizitën më 24.11.2012, në pjesën jugore të Mitrovicës, të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian, ku niveli i kontaminimit me plumb është shumë i lartë.

Albert Kinolli, me theks të veçantë tha se grupi punues ka realizuar vizitën në terren në pjesën jugore të Mitrovicës. Në këtë takim morën pjesë nënkryetar i KK të Mitrovicës, z. Haziraj së bashku me kryetarin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë në krye me Ferid Aganin, përfaqësuesit e Minsitrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor përfaqësuesit e Organizatës Ndërkombëtare MeryCorps, në krye me drejtorin ekzekutiv për Kosovë, z. Lee Norrgard.

Nënkryetari z. Haziri e njoftoi Komisionin se KK i Mitrovicës ka ndarë 8 hektarë për pjesëtarët e komunitetit në fjalë. Në këtë drejtim, menaxhimi i Organizatës Ndërkombëtare Mercy Corps me mjetet financiare të USAID-it, UNDP-së dhe Zyrës Evropiane për zhvillim, ka ndërtuar shtëpi të reja për këtë komunitet. Në komunën e Mitrovicës ekziston Zyra për Komunitete dhe se punët kryhen në interes të komuniteteve, që jetojnë dhe punojnë në këtë komunë.

Është vizituar edhe Shtëpia e Shëndetit, dhe jemi dëshmitar në marrjen e analizave të rregullta në gjakun e fëmijëve të këtyre komuniteteve. Me këtë rast, ministri z. Ferid Agani ka deklaruar se deri më sot nuk ka raste që ndonjë fëmijë ka më tepër se doza e lejuar me plumb ose të jenë nën trajtim. Albert Kinolli, tha se situta tani është shumë më e favorshme, ngase 136 familje janë kthyer në pjesën Jugore të Mitrovicës, janë ndërtuar 122 shtëpi për 2.000 pjesëtarë të këtyre komuniteteve, 14 shtëpi janë renovuar, 114 nxënës vijojnë mësimet në shkolla. Momentalisht në kamp jetojnë pesë familje, kurse deri në fund të vitit 2012, edhe këtyre familjarëve do t'u ndërtohen shtëpitë. Ai shtoi se kjo pike, do të përfshihet në Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian.

Kryesuesi – e njoftoi Komisionin se gjatë vizitës janë vërejtur përparime në integrimin e komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian në të gjitha sferat, si në shkollim, në punësim dhe në lirinë e lëvizjes. Infrastruktura e banim ishte në nivel shumë të mirë, ku janë ndërtuar shtëpi të reja, janë hapur fabrika për prodhimin e briketave.

Për të gjitha të arriturat duhet falënderuar Organizatën Ndërkombëtare MeryCorps, USAID-it, UNDP-së dhe Zyrës Evropiane lidhur me zhvillimet të zhvendosjes së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian, në zonën jugore të Mitrovicës.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic